



Planuar / Doretuar Puniljeno/Prodato Rrezevit/Delivory	06-06-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	3290/2022		17.



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.405/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyll Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.405/2022 të datës 21.04.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga

kundër Vendimit me Nr.478/2022 të datës 29.03.2022 të Menaxherit të Njëjesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.405/2022 e datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.478/2022 i datës 29.03.2022 i Menaxherit të Njëjesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- III. Detyrohet Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në vendin e punës Menaxhere e Njëjesisë së Burimeve Njerëzore sipas Akt Emërimit të datës 14.01.2013.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 17.11.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 1250/2021 me të cilin ka bërë caktimin e ankueses si Zëvendësuese e Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve, deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Ankuesja përmes emailit këtë vendim e ka pranuar më datë 17.11.2021, mirëpo më datë 18.11.2021 ka njoftuar Zëvendësuesen e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme se vendimin do ta zbatoj edhe pse është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr.1250/2021 të datës 17.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 09.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:629/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 09.03.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.104/2022 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses duke e obliguar Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme që t'a kthej në vendin e punës Menaxhere e Burimeve Njerëzore.

Ndaj ankueses e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 14.01.2013 në pozitën "Menaxhere e Njesisë së Burimeve Njerëzore" në Ministrinë e Punëve të Brendshme Menaxheri i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 29.03.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 478/2022 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankueses nga pozitë Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën Udhëheqës i Qendrës për Akomodim në Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve nga data 29.03.2022 deri më datë 28.09.2022.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 478/2022 të datës 29.03.2022 të Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes postës më datë 20.04.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 21.04.2022 është pranuar dhe është me numër të anekses A.nr.405/2022 dhe me Nr. Prot:2277/2022.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me Nr. Prot:629/2022 të regjistruar me numër A.nr.405/2022 e datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 478/2022 të datës 29.03.2022 të Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin A.nr.104/2022 të datës 09.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës; Vendimin me Nr. 469/2022

i datës 25.03.2022; Vendimin me Nr. 467/2022 i datës 25.03.2022; Emailin e datës 29.03.2022 nga ankuesja; Zarfën e datës 20.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 12.05.2022; Akt Emërimin e datës 14.01.2013 për ankuesen; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Menaxher i Personelit dhe Përshkrimin e detyrave të punës Udhëheqës i Qendrës së Akomodimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.478/2022 i datës 29.03.2022 i Menaxherit të Njëjesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon që Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka respektuar Vendimin A.nr.104/2022 të datës 09.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës; Vendimi me Nr.478/2022 i datës 29.03.2022 i Menaxherit të Njëjesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme është nxjerr në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, Rregulloren Nr. 14/2020 për Transferimin e Neptunëve Civil dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka respektuar Vendimin A.nr.104/2022 të datës 09.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me vendimin e lartcekur është obliguar Sekretarja e Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme që t'a kthejë në vendin e punës Menaxhere e Burimeve Njerëzore, ndërsa në bazë të dëshmive të lëndës, më datë 28.03.2022, Këshilli, është njoftuar nga Zyra e Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme se sipas Vendimit me Nr. 469/2022 të datës 25.03.2022 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme është bërë shfuqizimi i Vendimit me Nr. protokollin 125/2021 i datës 17.11.2021 për caktimin e ankueses zëvendësueses e Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve. Bazuar në këtë vendim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. protokollin 125/2021 i datës 17.11.2021 është shfuqizuar me Vendimin A.nr.104/2022 të datës 09.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, dhe askund në Vendimin me Nr. 469/2022 të datës 25.03.2022 nuk përcaktohet se ankuesja kthehet në vendin e punës sipas dispozitivit të Vendimit A.nr.104/2022 të datës 09.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, si rrjedhojë Kolegji e konsideron që vendimi i Këshillit nuk është zbatuar ashtu siç parashihet me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, i cili përcakton se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, përkundrazi ankuesja me Vendimin me Nr.478/2022 e datës 29.03.2022 të Menaxherit të Njëjesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme është transferuar në mënyrë të përkohshme në pozitën Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Riintegrimin e

Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, kështu që pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar edhe për faktin që bazuar në të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se para nxjerrjes së Vendimit me Nr. 469/2022 të datës 25.03.2022 nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në të njëjtën datë është nxjerr Vendimin me Nr. 467/2022 me të cilin ndër të tjera është caktuar zyrtar përgjegjës për menaxhimin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, fakt ky që vërteton se Vendimi A.nr.104/2022 i datës 09.03.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është zbatuar asnjëherë, dhe Ministria e Punëve të Brendshme ka vë në lajthitje Këshillin me rastin e njoftimit që vendimi është zbatuar.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.478/2022 të datës 29.03.2022 të Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht neni 52, ka paraparë transferimin e përkohshëm të nëpunësve civil në disa raste, si rrjedhojë transferimi i ankueses ka ndodhur si vazhdimësi e caktimit të saj si zëvendësuese e Udhëheqësit të Qendrës për Akomodim në Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, kështu që fakti që ankuesja pozitë Menaxhere e Personelit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme e ushtron që nga vitit 2006, ky përbën një fakt shumë të rëndësishëm që nëpunësit civil që kanë akt emërim të përhershëm duhet të ushtrojnë pozitën e tyre respektive, ndërsa lëvizja nga pozita duhet të bëhet për arsye shumë bindëse.

Fakti që para transferimit të përkohshëm të ankueses, është bërë edhe caktimi i zëvendësuesit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura lidhur me mundësin e zëvendësimit të nëpunësve civil ka paraparë në rastet kur nëpunësi civil përkohësisht nuk e ushtron pozitën (pushim vjetor, mjekësor, trajnim apo të ngjashme), ndërsa aplikimi i dispozitave të nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i referohet rastet kur nëpunësit mungojnë në punë deri në dymbëdhjetë muaj (pushim i lehonisë, pezullim i marrëdhënies së punës e të ngjashme). Rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me Vendimin me Nr.478/2022 të datës 29.03.2022 të Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ankueses i është shkaktuar pasiguri juridike, sepse kur pozitat janë të lira nuk është e domosdoshme që ato të plotësohet me vendime për zëvendësues apo me vendime për transferim të përkohshëm për faktin që institucionet kanë mundësi që këto pozita t'i mbulojnë me procedurë përmes lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç parashihet me nenin 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publike, sepse pozita Qendra për Akomodim në Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve është e paraparë si pozitë me Rregulloren (ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ministria e Punëve të Brendshme edhe në përgjigjen në ankesë të datës 12.05.2022 është konfirmuar që kjo ministri ende nuk ka filluar procesin e ristrukturimit për faktin që rregullorja përkatëse gjegjësisht Rregullorja (ZKM) Nr.01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme është në plotësim ndryshim dhe deri sa të bëhen ndryshimet e nevojshme nuk mund të përfundoj në tersi procesi i sistemimit si pasoj e ristrukturimit, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse Ministria e Punëve të Brendshme ka mbetur si ministria me emërtim siç ka qenë edhe në të kaluarën, përveç faktit që Ministria e Administratës Publike i është bashkuar, atëherë deri në përfundimin e procesit të miratimit të rregullores përkatës dhe sistemimit të nëpunësve sipas kësaj rregullore, atëherë transferimi i përkohshëm i ankueses nga vendi i saj i punës të cilën e ka me akt emërim, nuk duhet të bëhet, ndërsa në momentin kur fillon sistemimi i nëpunësve civil si pasoj e ristrukturimit atëherë të veprohet në pajtim me nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil për të gjitha pozitat që preken nga ristrukturimi.

Lidhur me atë që Menaxheri i Njëjesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme i caktuar si zëvendësues ka nxjerr vendim për transferim të përkohshëm për ankuesen e cila këtë pozitë e ka mbajtur me akt emërim të përhershëm, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se neni 29 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"1. Zyrtari publik ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në pajtim me ligjin. 2. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë pa vonesë mbikëqyrësin e tij, në rast dyshimi për një konflikt interesi dhe të zbatojë urdhrat e institucionit për parandalimin e konfliktit të interesit"*, ndërsa në rastin konkret Menaxheri i Njëjesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme i caktuar si zëvendësues në mënyrë direkte apo indirekte ka interes në këtë çështje juridike.

Po ashtu Vendimi me Nr.478/2022 i datës 29.03.2022 i Menaxherit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme është nxjerr pa u analizuar mirë nëse është vepruar në pajtim me nenin 5 paragrafi 1 të Rregulloren (QRK) Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar"*, kështu që është pse Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve është në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk ka asnjë dëshmi që udhëheqësi i këtij departamenti të këtë kërkuar një transferim të tillë. Po ashtu para transferimit ka munguar komunikimi respektivisht ankuesja nuk është informuara për këtë proces siç parashihet me nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *"Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimarrje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës"*, nenin 5 paragrafi 2 të Rregulloren (QRK) Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve, i cili përcakton se:

*“Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet”,* kështu që me këtë veprim është shkëlur neni 9 paragrafi 2 dhe neni 92 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, arsyetimi i Vendimit me Nr.478/2022 të datës 29.03.2022 të Menaxherit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është i pa qartë dhe kontradiktor sepse është marr pa u mbështetur në asnjë provë juridike dhe është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe po ashtu në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni i cili përcakton se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërligjor apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*. Po ashtu sipas këtyre Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr.478/2022 i datës 29.03.2022 i Menaxherit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme është i paligjshëm në kuptim të nenet 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj anulimi i këtij vendimi bëhet me qëllim për të vendosur ligjshmërinë siç parashihet me 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë”*, kështu që pretendimi i ankueses se Vendimi me Nr.478/2022 i datës 29.03.2022 i Menaxherit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme është nxjerr në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është i bazuar.

Bazuar në të lartcekurat, Sekretarja e Ministrisë së Punëve të Brendshme, është e obliguar që ankuesen ta kthej në vendin e punës Menaxhere e Njësisë së Burimeve Njerëzore sipas Akt Emërimit të datës 14.01.2013 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës që rrjedhin sipas akt emërimit.

Me dispozitat e nenet 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, ndërsa me dispozitat e nenet 24 paragrafi 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenet 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.405/2022

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Eshref SHABANI**  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

